

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Turqia rrit presionin ndaj Greqisë: Kërkon sërish çmilitarizimin e ishujve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/turqia-rrit-presionin-ndaj-greqise-kerkon-serish-cmilita-rizimin-e-ishujve-i587063
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 11:23:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d6bffa49408f7b683980ff6f76f321fa3aa3e493914312540d5c7b7378fc0df74
TEKSTI	873f18e5aba8f3645bf8ef4b2cf917f3c5578f9fb38f89c3c8a5ea420ab390b8
PAMJA	0d9481aa8efd4279528995a11ef4b69799a195e1a203007a23edbc0e26644d64

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	26a1631093ffab0dfe6f69ddd8ed062900d7ef378f76e77a6c7a8b022c5f4ce8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/26a1631093ffab0dfe6f69ddd8ed062900d7ef378f76e77a6c7a8b022c5f4ce8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



IE SHBA dhe Egjipti diskutojnë krizat rajonale. Keshilltar i Trumpit telefonon Kajron: Po cenohet siguriaArtistet nga Prizreni vene ne skene dramen psikologjike "Pylli" ne fundit

Turqia rrit presionin ndaj Greqisë: Kërkon sërish çmilitarizimin e ishujve



19 Shtator 2026, 14:35Bota TEMA



Turqia ka rikthyer me forcë kërkesën për çmilitarizimin e ishujve grekë në Egje, duke e shtrirë tashmë qëndrimin jo vetëm në nivelin e presidentit Recep Tayyip Erdogan dhe ministrit të Jashtëm Hakan Fidan, por edhe të Ministrisë së Mbrojtjes.

Zëdhënësi i Ministrisë turke të Mbrojtjes, Zeki Akturk, kritikoi vizitën e fundit të kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis në Kastellorizo, duke deklaruar se prania ushtarake greke në ishull nuk kontribuon në paqen dhe stabilitetin në Egje dhe Mesdheun Lindor.

Sipas Ankarasë, autoritetet turke kanë monitoruar nga afër vizitën e Mitsotakis dhe kontaktet e tij me njësitë ushtarake të vendosura në ishull.

Akturk argumentoi se prania e personelit ushtarak dhe e një anijeje luftarake në Kastellorizo bie ndesh me statusin që Turqia thotë se i është përcaktuar ishullit nga Traktati i Paqes i Parisit i vitit 1947.

Ai paralajmëroi gjithashtu se Turqia nuk do të pranojë veprime që, sipas saj, synojnë krijimin e fakteve të kryera duke shkelur statusin e çmilitarizuar të ishujve.

Deklarata vjen pas një serie paralajmërimesh të ngjashme nga nivelet më të larta të shtetit turk.

Ministri i Jashtëm Hakan Fidan deklaroi këtë javë se militarizimi i ishujve që Ankaraja i konsideron të çmilitarizuar përbën "kërcënim për Turqinë", ndërsa Erdogan i kishte kërkuar më herët Athinës të "ndryshojë kurs".

Greqia i kundërshton kategorikisht pretendimet turke.

Ministria e Jashtme greke thotë se pretendimet e përsëritura të Ankarasë për çmilitarizimin e ishujve nuk kanë bazë në të drejtën ndërkombëtare dhe se statusi i ishujve të Egjeut përcaktohet qartë nga traktatat ndërkombëtare.

Athina argumenton gjithashtu se, si shtet sovran, Greqia ka të drejtë të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e territorit të saj.

Tensionet janë shtuar edhe nga afrimi ushtarak i Greqisë me Izraelin dhe planet e Athinës për sistemin e ri të mbrojtjes ajrore "Achilles Shield", si dhe blerjen e sistemeve izraelite PULS.

Në të njëjtën kohë, Ministria turke e Mbrojtjes konfirmoi zhvendosjen e njësisë të Brigadës së 51-të Komando në zonën Söke, përballë ishullit grek të Samosit. Ankara tha se lëvizja është pjesë e një plani operacional të miratuar që në qershor dhe mohoi se lidhet me vizitën e Mitsotakis në Kastellorizo. Athina po monitoron gjithashtu rritjen e aktivitetit turk në Egje, përfshirë shkeljet me dronë dhe rikthimin gradual të incidenteve mes avionëve ushtarakë.Përplasjet e ardhshme mund të lidhen edhe me projektin “Blue Homeland” të Turqisë, parqet detare të planifikuara nga Greqia dhe projektin e interkonjeksionit elektrik Greqi-Qipro.

Megjithëse kanalet diplomatike mes dy vendeve mbeten të hapura, rikthimi i çështjes së çmilitarizimit në disa nivele të qeverisë turke tregon se kjo temë po kthehet sërish në një prej pikave kryesore të tensionit mes Ankarasë dhe Athinës.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

SHBA dhe Egjipti diskutojnë krizat rajonale, këshilltari i Trumpit telefonon Kajron: Po cenohet siguria

13:15 Bota

Përplasje në horizont? Izraeli kërkon "kompensim" nga SHBA-të

12:55 Bota

Kanadaja dhe BE, modelet e bashkëpunimit dhe anëtarësimi i asociuar

11:35 Bota

Vrasje brutale në Kolumbi! Autorja i zuri pritë para biznesit, biznesmeni 61-vjeçar vritet me 11 plumba

10:05 Bota / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.